



# **INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË**

## **RAPORTI I TRETË VJETOR**

**2002 – 2003**

**drejtuar**

**Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm  
të Kombeve të Bashkuara**

**10 korrik 2003**

**Tel: ++381 38 501 401**

**Fax: ++381 38 545 302**

**e-mail: [ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org](mailto:ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org)**

**web site: [www.ombudspersonkosovo.org](http://www.ombudspersonkosovo.org)**

## Tabela e përmbajtjes

<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>ASPEKTE TË CAKTUARA TË SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË .....</b>	<b>3</b>
<b>INFRASTRUKTURA DHE QEVERISJA.....</b>	<b>3</b>
<b>KAOSI LIGJOR .....</b>	<b>4</b>
<b>ANËTARËT E BASHKËSIVE MINORITARE BRENDA DHE JASHTË KOSOVËS .....</b>	<b>6</b>
<b>PERSONAT E ZHDUKUR DHE KRIMET E PAZGJIDHURA .....</b>	<b>7</b>
<b>ÇËSHTJE TJERA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT .....</b>	<b>7</b>
<b>AKTIVITETET DHE VEPRIMET E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT .....</b>	<b>7</b>
<b>QASJA NË INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT .....</b>	<b>7</b>
<b>PËRMBLEDHJA E RASTEVE .....</b>	<b>8</b>
<b>ZGJËRIMI I AKTIVITETEVE .....</b>	<b>9</b>
<b>PËRKRAHJA FINANCIARE DHE NË TË MIRA TË TJERA .....</b>	<b>10</b>
<b>PROSPEKTET PËR INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT NË TË ARDHMËN .....</b>	<b>11</b>
<b>ANNEX 1: PËRMBLEDHJE STATISTIKORE E RASTEVE .....</b>	<b>12</b>
<b>ANEKSI 2: PËRMBLEDHJE E KËRKESAVE PËR MASA TË PËRKOHSHME.....</b>	<b>14</b>
<b>ANEKSI 3: PËRMBLEDHJET E RAPORTEVE .....</b>	<b>16</b>
<b>ANEKSI 4: PËRMBLEDHJET E LETRAVE TË ZGJEDHURA ME TË CILAT KËRKOHET NDIHMË OSE SHËRBIME .....</b>	<b>26</b>

## **HYRJE**

Ky Raport vjetor është lëshuar në pajtim me Nenin 17.1 të Rregullores 2000/38 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, dhe Rregullën 22.1 të Rregullave procedurale të Institucionit të Ombudspersonit.

Ky Raport i dytë vjetor mbulon vitin e dytë të plotë të veprimeve të Ombudspersonit, nga 1 korriku 2002 deri më 30 qershor 2003. Ai ka dy sekcione kryesore. I pari përbën një analizë të shkurtër të aspekteve të caktuara të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nga perspektiva e Ombudspersonit, kurse i dyti është mbi aktivitetet dhe veprimet e Institucionit të Ombudspersonit.

## **ASPEKTE TË CAKTUARA TË SITUATËS SË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË**

### **Infrastruktura dhe Qeverisja**

Në Raportin e Dytë Vjetor, ne kemi theksuar një numër të vështirësive që lindin nga natyra jo demokratike e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe roli i tij si zëvendësim i shtetit. Edhe pse gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet është bërë bartja e funksioneve të caktuara në autoritetet vendore komunale dhe qendrore, UNMIK-u mbetet në kontroll të elementeve më të rëndësishme të autoritetit qeveritar, siç janë, për shembull, gjyqësia, policia dhe legjislatura. Situata ekzistuese rezulton me shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut dhe keqpërdorim të autoritetit nga ana e UNMIK-ut, që reflekton indiferencën e tij ndaj sundimit të ligjit me të cilin janë të obliguara vendet tjera të Evropës. Konkludimi që kemi arritur në Raportin tonë të Dytë Vjetor, që njerëzit e Kosovës janë të privuar nga mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore – tani katër vite nga përfundimi i konfliktit – nga ana e vetë entitetit të themeluar t’i garantojë ato, ende qëndron.

Siç është konfirmuar me anë të vizitave të shumta konsulltuese Gjykatës Supreme, gjykatave të qarkut, gjykatave të caktuara komunale, disa prokurorive dhe autoriteteve të UNMIK-ut që merren me administrimin e gjykatave, gjyqësia vazhdon të jetë pikë e dobët për një Kosovë të dëshiruar demokratike. Ombudspersoni konsideron që numri i të punësuarve në sistemin gjyqësor në Kosovë është tepër i vogël, që rezulton në vonesa të gjata në punën me rastet dhe zgjidhjen e tyre. Edhe kur gjykatat kanë përfunduar shqyrtimin e tyre të rastit dhe aktgjykimi ka marrë formën e prerë, vonesa e UNMIK-ut për të themeluar apo emëruar pozitat e zyrtarit për ekzekutim në gjykatat civile ka pasur efektin t’i bëjë këto aktgjykime jo efektive pasi që askush nuk ka qenë përgjegjës për ekzekutimin e tyre. Pagat e ulëta për gjykatësit dhe të punësuarit tjerë në gjykata, posaqërisht së bashku me kërcënimet për jetën e tyre dhe të familjeve të tyre nëse marrin vendime të caktuara, do të thotë që shumë nga këta punonjës profesional braktisin pozitat e tyre gjyqësore në mënyrë që të fillojnë praktikën ligjore private apo të kryejnë punë të tjera. Si rezultat, gjykatat nuk janë në gjendje të luajnë rol të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

## Kaosi ligjor

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, është bërë pak të qartësohet ligji i aplikueshëm në Kosovë. Një nga parakushtet themelore të sundimit të ligjit është ai që ligji duhet të publikohet në mënyrë që të mund të konsiderohet si ligj, në pajtim me standardet evropiane që qeverisin “ligjshmërinë” – qasja, parashikueshmëria dhe kualiteti i ligjit – të cilat bashkohen për ta mbrojtur individin nga veprimet arbitrare të qeverisë. Lidhur me qasjen, ligjet e lëshuara nga UNMIK-u apo të shpallura nga Kuvendi i Kosovës nuk publikohen në pajtim me ligjin e aplikueshëm që qeveris publikimin zyrtar të tyre. Duket që, edhe pse UNMIK-u e konsideron publikimin në faqen e tyre të internetit si një gjë që plotëson kushtet e kërkuara, ata prapëseprapë dështojnë të publikojnë Rregulloret e tyre edhe në këtë medium. Deri në fund të qershor të vitit 2003, vetëm katër Rregullore të UNMIK-ut për këtë vit janë publikuar në faqen e tyre të internetit. Aq më tepër, Ombudspersoni vetëm rastesisht zbuloi që Rregullorja e tetë e UNMIK-ut në këtë vit në fakt kishte ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë. Kjo Rregullore ishte nënshkruar më 15 prill 2003, por asnjë kopje e saj nuk i ishte përcjellur Institucionit. Duket që verzionet e kësaj Rregulloreje të UNMIK-ut nuk ekzistojnë as në gjuhën shqipe ose serbe.

Në këtë kontekst, e vlen të merren në konsiderim situata e palakmueshme e individëve në Kosovë, të cilët nuk i kanë në dispozicion mjetet që i kanë të punësuarit juridik të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë për të zbuluar cilat janë ligjet e aplikueshme në Kosovë. Megjithatë, si këta individë, të cilët u nënshtrohen këtyre ligjeve, ashtu edhe gjykatësit, zyrtarët e gjykatave dhe të gjithë të tjerët që praktikojnë ligjin, kanë qasje shumë të kufizuar në internet. Edhe pse gjykatave, me vonesë të konsiderueshme, u shpërndahen verzionet me shkrim të ligjeve të aplikueshme, kopje të këtyre ligjeve nuk i ofrohen të gatshme publikut. Gjithashtu, siç e kemi cekur shumë herë, ligjet në Kosovë duhet të publikohen në të tri gjuhët zyrtare. Fatkeqësisht, mungesa e përkthimeve vazhdon të jetë një problem, dhe kualiteti i përkthimeve të atyre ligjeve që përkthehen është aq i dobët sa që ata që e praktikojnë ligjin dhe që punojnë në gjuhën shqipe apo serbe shpesh nuk mund ta përcaktojnë kuptimin e tyre.

Një problem tjetër i vazhdueshëm është mungesa e periudhës *vacatio legis* (periudha kohore prej nënshkrimit të ligjit deri në hyrjen e tij në fuqi) lidhur me Rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet e shpallura nga Kuvendi i Kosovës. Rregulloret dhe ligjet deklarohen të jenë në fuqi prej momentit të nënshkrimit nga ana e PSSP-së ose, në rastet më të mira, brenda disa ditëve nga data që nënshkruhen. Pothuajse të gjitha Rregulloret e UNMIK-ut përfshijnë një dispozitë përmbljedhëse që deklaron që Rregullorja shfuqizon çdo dispozitë të ligjit apo Rregullores në fuqi që është në kundërshtim me Rregulloren e re. Shumë nga to, e në veçanti ato që marrin formën e deklaratave të paqarta mbi politikën e jo atë të standardeve të qarta ligjore, gjithashtu përfshijnë dispozita që për qëllim të implementimit efikas të tyre lejojnë lëshimin e udhëzimeve administrative dhe akteve tjera nënligjore . Në anën tjetër, deri në atë kohë kur të lëshohen këto akte nënligjore , nga autoritetet qeveritare dhe ata që praktikojnë ligjin pritet ta zbatojnë atë Rregullore të paqartë. Edhe me vullnetin më të madh për ta bërë këtë, ata që janë të ngarkuar me implementimin dhe zbatimin e ligjit ballafaqohen me vështirësi të mëdha gjatë përbushjes së obligimeve të tyre profesionale. Prandaj, e tërë popullsia, si e tillë, gjendet në një paqartësi ligjore.

Një atribut i rëndësishëm i respektit të sundimit të ligjit është që dega ekzekutive e qeverisë të mos konsiderohet të jetë mbi ligjin. Në Kosovë, pasi që ekzekutivi dhe legjislatura janë një individ i njejtë, ky parim është automatikisht i rrezikuar. Largimi i një kategorie të caktuar të ankesave lidhur me të drejtat e njeriut nga juridikcioni i gjykatave, vendosja e tyre nën

kontroll të organeve administrative të UNMIK-ut dhe pamundësia që vendimet e marra të shqyrtohen në pajtim me ligjin konfirmon që shkrirja e funksioneve ekzekutive me ato legjislative, së bashku me anulimin e rolit të gjyqësisë nuk ka shërbyer në interes të të drejtave të njeriut në Kosovë.

Siç është raportuar më herët, UNMIK-u dhe KFOR-i së paku teknikisht kanë pranuar që individët të cilëve u kanë shkaktuar lëndime, dëme ose humbje të pronës do të duhej të pranojnë kompenzim, edhe pse as njëri as tjetri nuk kanë pranuar mundësinë e dhënies së dëmshpërblimit. Që të dy kanë themeluar “zyret për ankesa”, që janë interne. Mirëpo, natyra e procedurës në UNMIK dhe në KFOR dallon dukshëm. UNMIK-u nuk mundëson që individët të dëgjohen ose të përfaqësohen nga ana e këshilltarit ligjor gjatë procedurave të tyre, dhe të gjitha vendimet merren nga një kolegji i përbërë nga punonjësit e UNMIK-ut. I vetmi mjet i mundshëm i ankimit ndaj këtij vendimi të instancës së parë është dërgimi i një “memorandumi” Drejtorit të Administratës së UNMIK-ut. Për dallim nga kjo, edhe pse në instancën e parë në procedurën pranë KFOR-it është e kërkuar që vetëm një oficer i KFOR-it të marrë vendimin, procesi i ankimit ndaj atij vendimi përfshin shumë elemente të procedurës korrekte ligjore, duke përfshirë edhe mundësinë që individi të dëgjohet ose të përfaqësohet ligjshëm.

Mbetet e pamundur të merren informata nga UNMIK-u lidhur me statusin e kërkesave në pritje për t’u zgjidhur apo të dhëna statistikore rreth numrit dhe llojit të kërkesave të zgjidhura. Duket që edhe kërkesat në të cilat UNMIK-u është gjetur përgjegjës mbesin në pritje të përhershme për t’u zgjidhur, pasi që Kombet e Bashkuara duket të mos kenë ndarë ndonjë pjesë të buxhetit të tyre për pagesë të kërkesave të tilla. Në anën tjetër, KFOR-i ofron informata të tilla dhe ka ofruar kompenzim financiar në një numër të rasteve.

Megjithatë, përkundër përpjekjeve mirëdashëse të KFOR-it për të zgjidhur paditë kundër tyre, ky sistem enda ka disa mangësi. Në mesin e tyre, mangësia më e madhe qëndron në kufizimin e sistemit të padive vetëm kundër Shtabit të Përgjithshëm të KFOR-it në Prishtinë. Kontigjentet individuale të KFOR-it mund të zgjedhin nëse do të jenë subjekt i juridiksionit të komisionit të ankesave të KFOR-it, mirëpo nuk ekziston kurrfarë obligimi apo presioni të përgjithshëm publik që kontigjentet do të duhej ta pranojnë këtë juridiksion. Prandaj, individët që dëshirojnë të kërkojnë kompenzim për dëmet e shkaktuara nga kontigjentet e shteteve të ndryshme mund të mos kenë mundësinë ta bëjnë këtë përmes sistemit të kufizuar të kërkesave të themeluar nga ana e KFOR-it në Kosovë.

Në Raportet e mëparshme, Ombudspersoni ngriti shqetësime serioze lidhur me paraburgimin e banorëve të Kosovës për periudha të gjata kohore sipas Urdhërave Ekzekutiv të lëshuar nga PSSP-ja apo Komandanti i KFOR-it (COMKFOR). Edhe pse paraburgime të tilla kanë ndodhur shumë rrallë gjatë periudhës për të cilën raportohet, mungesa e përgjegjjes në Raportet e Ombudspersonit lidhur me paligjshmërinë dhe kundërshtimet me të drejtat e njeriut të rrezikuara me ato paraburgime pasqyron një mospërfillje për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Duke marrë parasysh vlerësimin e përgjithshëm politik të PSSP-së dhe COMKFOR-it që situata e sigurisë në Kosovë është përmirësuar dukshëm, duket që kjo do të ishte një kohë e përshtatshme për të shfuqizuar zyrtarisht çdo aspekt të paraburgimeve të paligjshme nga ana e UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Për dallim nga periudhat tjera për të cilat është raportuar, një kategori e problemeve që janë parashtruar pranë Ombudspersonit më shpesh gjatë kësaj periudhe ka të bëjë me pranimin

kontradiktor të dokumenteve civile (sh.b. certifikatat e lindjes, vdekjes ose martesës) të lëshuara nga UNMIK-u. Në Kosovë, individët që paraqiten për të pranuar përfitime të caktuara, për shembull ato që u takojnë individëve që janë paaftësuar apo familjarëve të personave që kanë vdekur gjatë konfliktit, duhet të paraqesin dokumente të UNMIK-ut në mënyrë që të konfirmojnë marrëdhëniet e tyre familjare. Për shembull, autoritetet në Kosovë kanë refuzuar të pranojnë certifikata tjera të martesës përveç atyre të lëshuara nga UNMIK-u, edhe në rastet kur martesa është bërë shumë kohë para se të themelohet UNMIK-u si administratë “e përkohshme” civile në këtë territor. Në anën tjetër, disa shtete të jashtme, për shembull Gjermania, refuzojnë të pranojnë certifikatat e martesës të lëshuara nga UNMIK-u, edhe kur martesa është bërë pranë autoriteteve të UNMIK-ut. E vetmja mundësi për një çift që dëshiron që martesa e tyre të pranohet jashtë Kosovës është që edhe njëherë të kalojnë nëpër ceremoninë e martesës pranë një autoriteti paralel në ndonjë rajon serb brenda Kosovës, në mënyrë që të marrin një certifikatë të martesës që është e pranuar në të gjitha vendet. Probleme të ngjajshme paraqiten edhe për individët që përpiqen të marrin vizat për udhëtime jashtë vendit në rastet kur ata mund të paraqesin vetëm certifikatën e lindjes të UNMIK-ut.

### **Anëtarët e bashkësive minoritare brenda dhe jashtë Kosovës**

Edhe pse gjatë periudhës për të cilën raportohet deri në një masë kanë ndodhur përmirësime, siç është për shembull liria e lëvizjes dhe siguria e individëve që nuk janë të përkatësisë etnike shqiptare, së paku në disa pjesë të Kosovës, situata e përgjithshme ende mbetet shumë e vështirë. Çështja e kthimit të anëtarëve të bashkësive minoritare brenda dhe jashtë Kosovës në shtëpitë e tyre në Kosovë ende mbetet çështje shumë e politizuar, me ç’rast si UNMIK-u ashtu edhe liderët politik të Serbisë dhe Malit të Zi pajtohen që të gjithë të zhvendosurit brenda vendit do të duhej të kthehen në Kosovë, por për arsye të ndryshme politike. Megjithatë, duke pasur parasysh mungesën e sigurisë në mbarë krahinën, ekonominë e mjerë dhe vonesat në zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, nuk është befasuese që tepër pak të zhvendosur brenda vendit janë kthyer gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Në pranverë të vitit 2003, Armata Kombëtare Shqiptare shkatërroi një urë në veri të Kosovës dhe publikisht pranoi të ketë kryer këtë akt terrorist. Ombudspersoni ua dërgoi një letër të hapur me të cilën dënoi këtë akt, duke theksuar që rruga përpara për Kosovën është përmes kanaleve demokratike e jo përmes terrorizmit. Gjithashtu, në pranverë të vitit 2003, një banor serb i fshatit Vërbovc ishte vrarë në rrethana që ngrisin dyshim të fortë që ai kishte qenë viktimë e dhunës ndëretnike. Si përgjegjje në heshtjen pothuajse të plotë të opinionëve kyçe në Kosovë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, Ombudspersoni lëshoi një deklaratë publike në të cilën theksoi që qëndrimi i treguar me atë nivel të heshtjes krijonte bindjen që opinioni publik ishte indiferent ndaj dhunës ndëretnike, duke vënë me këtë rast në pyetje të ardhmën e një Kosovë multietnike.

Rrethanat tregojnë që, nëse kjo arrihet ndonjëherë, do të nevojitet kohë e gjatë për kthimin në numra të mëdhenj të ish-banorëve jo shqiptarë të Kosovës. Si rezultat, të gjitha politikat dhe përkrahjet financiare që kanë të bëjnë me “kthimin” do të duhej ta reflektojnë këtë realitet. Duke pasur parasysh faktin që të gjitha palët pajtohen që kthimi do të duhej të jetë “vullnetar”, duket që përkrahja do të duhej t’u ofrohet individëve të zhvendosur ose të kthehen në Kosovë ose të ndërtojnë jetën e tyre diku tjetër nëse ajo është zgjedhje e tyre. Në vend të kësaj, duket që përkrahja financiare është duke u ofruar më shumë në baza gjeografike se sa në baza njerëzore.

## **Personat e zhdukur dhe krimet e pazgjidhura**

Katër vite pas konfliktit, disa mija njerëz ende gjenden në listën e të zhdukurve. Shqiptarët etnik u zhdukën gjatë konfliktit dhe periudhës para konfliktit, derisa personat e etnicitetit jo shqiptar kryesisht janë zhdukur pas arritjes së KFOR-it dhe UNMIK-ut në Kosovë. Lidhur me personat që janë zhdukur në kontekst të konfliktit në Kosovë, nuk është bërë sa duhet nga ana e qeverisë së Serbisë dhe Malit të Zi, qoftë me iniciativë të saj apo në bashkëpunim me UNMIK-un, për ndriçimin e fatit të tyre. UNMIK-u, që këto katër vitet e fundit ka ushtruar juridikcionin mbi çështje të tilla, gjithashtu ka dështuar të merret në mënyrë adekuate me zhdukjen e banorëve të Kosovës pas themelimit të prezencës ndërkombëtare në këtë territor.

Siç është e shënuar në Raportet e mëparshme, autoritetet përgjegjëse të UNMIK-ut gjithashtu kanë dështuar të hetojnë krimet serioze që janë kryer pas arritjes së tyre, e në veçanti rastet që kishin të bëjnë me dhunën ndëretnike kundër pjesëtarëve të bashkësive jo shqiptare. Duket që një pjesë e këtij dështimi ka lindur për shkak të ndërrimit të shpeshtë të punonjësve të hetuesisë së Policisë së UNMIK-ut. Lidhur me këtë, themelimi i Njesisë së "krimeve të ftohta" nga ana e Policisë së UNMIK-ut, në pranverë të vitit 2003, për qëllim të rishqyrtimit të vrasjeve të pazgjidhura, mund të konsiderohet si një zhvillim pozitiv.

## **Çështje tjera të të drejtave të njeriut**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Republike Federale e Jugosllavisë/Serbia dhe Mali i Zi parashtruan Raportin e tyre të parë mbi pajtimin me Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtje të Pakicave. Serbia dhe Mali i Zi gjithashtu u bënë anëtare të Këshillit të Evropës dhe filluan procesin e ratifikimit të instrumenteve tjera të rëndësishme evropiane mbi të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, duket e qartë që situata momentale do të thërrasë për vendosjen e kushtit për ratifikimin e këtyre Konventave, që Serbia dhe Mali i Zi të mos jenë përgjegjëse për çfarëdo shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e autoriteteve ndërkombëtare ose vendore në Kosovë.

Në Raportin tonë të Dytë Vjetor, kemi theksuar që Kosova do të duhej të pregatitet për të qenë "vrimë e zezë e të drejtave të njeriut", në Evropë dhe në botë. Ky vështrim ende mbetet i saktë, posaçërisht kur të merret parasysh që UNMIK-u vazhdon të injorojë çfarëdo konstatimi që ai i ka shkelur të drejtat e njeriut të garantuara me konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

## **Aktivitetet dhe veprimet e Institucionit të Ombudspersonit**

### **Qasja në Institucionin e Ombudspersonit**

Mënyra e përgjithshme e ofrimit të qasjes Institucionit të Ombudspersonit e përshkruar në Raportet e mëhershme (zyret rajonale, ditët e hapura) ka vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet. Megjithatë, Ombudspersoni ka rritur numrin e vizitave në vendet në Kosovë ku është koncentrimi i të kthyerve jo shqiptarë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e natyrës së ngjajshme më shtetet tjera, për shembull me Ombudsmanin e Bosnës dhe Hercegovinës, Republikës së Sllovakisë, Sllovenisë, Suedisë,

Spanjës dhe Zvicrrës, në rastet kur intervenimi i këtyrë autoriteteve ishte i nevojshëm për të zgjidhur problemet me të cilat ballafaqoheshin individët nga Kosova. Ombuds Institucionet në Kroaci dhe Shqipëri gjithashtu kërkuan ndihmën tonë për rastet të cilat ishin në pritje për t'u zgjidhur pranë tyre.

Sa i përket shërbimeve të tij të mira, në shkurt të vitit 2003, Ombudspersoni, së bashku me zyrtarë të lartë të Institucionit, udhëtoi në Mal të Zi për të vizituar personat që ishin zhvendosur nga Kosova, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të angazhuara rreth problemeve me të cilat ballafaqohet kjo popullatë, dhe zyrtarët e qeverisë. Të gjithë u pajtuan që një problem i veçantë me të cilin ballafaqohen të zhvendosurit në Mal të Zi është dështimi i donatorëve ndërkombëtarë dhe bilateral për të adoptuar skemën e tyre të ofrimit të përkrahjes financiare pas krijimit të Serbisë dhe Malit të Zi. Donacionet vazhdojnë t'i sigurohen vetëm Beogradit, duke lënë shpërndarjen e metutjeshme të burimeve nën kontroll të autoriteteve serbe, të cilat i transferojnë Podgoricës pak ose aspak nga fondet, që nuk është për t'u befasuar.

Është e qartë që Institucioni i Ombudspersonit ka pak kuptim nëse Ombudspersoni nuk është në gjendje të angazhojë autoritetet kompetente lidhur me çështjet e ngritura nga individët me ankesa kundër atyre autoriteteve. Prandaj ishte një zhvillim jo i mirë kur, në fillim të vitit 2003, PSSP kishte paraqitur një praktikë të re sipas së cilës asnjë anëtar i stafit të UNMIK-ut nuk do të duhej të nënshkruajë dëftesën e pranimit apo të ofrojë çfarëdo forme tjetër të dëshmisë që UNMIK-u, apo së paku PSSP, ka pranuar çfarëdo korrespondence nga kushdo, e aq më pak nga Ombudspersoni. Gjatë hetimit të kësaj çështje, Ombudspersoni zbuloi që PSSP kishte ndaluar stafin e tij që mos nënshkruajë dëftesën e pranimit as për korrespondencë që i është drejtuar përmes postës. Në një kumtesë për media, Ombudspersoni theksoi që tipari kyç i qeverisjes së mirë demokratike është besimi që institucionet qeveritare e gëzojnë te njerëzit. Një besim i tillë fillon me transparencë dhe përgjegjësi e jo me atë që autoritetet qeveritare ta mbrojnë vetëvehten nga njerëzit. Ombudspersoni vërejti që nuk kishte dijeni për çfarëdo qeverie demokratike, autoritetet ekzekutive të së cilës refuzojnë të pranojnë korrespondencën si nga anëtarët e publikut, ashtu edhe nga institucionet e themeluara me ligj për qëllime urgjente të angazhimit të këtyrë autoriteteve. Pas kësaj, kjo praktikë, së paku sa i përket Institucionit të Ombudspersonit, ndryshoi.

### **Përmbledhja e rasteve**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht 3500 njerëz kontaktuan Ombudspersonin për këshillë ose ndihmë, ose për të paraqitur ankesa zyrtare. Përafërsisht 900 nga këta individë e kontaktuan personelin e zyrës në Prishtinë, duke përfshirë një numër të individëve që u takuan me përfaqësuesit e Institucionit gjatë vizitës së këtyrë përfaqësuesve në Mal të Zi, në shkurt të vitit 2003.

Gjatë 70 ditëve të hapura që janë mbajtur gjatë periudhës për të cilën raportohet, me Ombudspersonin janë takuar përafërsisht 1600 njerëz.

Që nga inaugurimi i Institucionit të Ombudspersonit më 21 nëntor 2000, jane parashtruar 991 aplikacione zyrtare. Gjithashtu, prej hapjes së Institucionit, Ombudspersoni ka hapur 27 hetime *ex officio*. Sikur edhe gjatë periudhave tjera për të cilat është raportuar, shumica e rasteve të hetuara nga Institucioni i Ombudspersonit kanë të bëjnë me çështje pronësore,



ankesa rreth çështjeve të procesit të rregullt gjyqësor, keqpërdorim të autoritetit, ankesa lidhur me çështje të punës apo çështje të pandëshkueshmërisë (shih Aneksin 1).

Nga numri i aplikacioneve individuale të parashtruara pranë Institucionit të Ombudspersonit nga inaugurimi i tij, Ombudspersoni ka refuzuar 414 aplikacione mbi bazën që nuk ka juridikcion të hetojë ankesat e paraqitura, apo mbi baza tjera të ngjajshme formale. Ai gjithashtu ka mbyllur 157 raste mbi bazën që problemet përkatëse ishin zgjidhur ose mbi bazën që aplikantët më nuk ishin të interesuar t'i vazhdojnë ankesat e tyre.

Prej 1 korrikut 2002 deri më 30 qershor 2003, Ombudspersoni ka lëshuar tetë raporte përfundimtare mbi raste individuale dhe dy raporte përfundimtare mbi hetimet *ex officio* (shih Aneksin 3 për përmbledhje të Raporteve).

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni bëri dymbëdhjetë kërkesa autoriteteve qeveritare për të ndërmarrë masa të përkohshme. Ai konsideron që pesë nga këto kërkesa ishin të suksesshme, dy ishin pjesërisht të suksesshme dhe pesë ishin të pasuksesshme (shih Aneksin 2).

### **Zgjerimi i aktiviteteve**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë vazhdoi të zgjerojë aktivitetet të përqëndruara drejt implementimit të plotë të mandatit të Institucionit. Përveç ofrimit të qasjes më të mirë individëve jashtë Prishtinës (shih më lart), Ombudspersoni gjithashtu praktikoi një metodë të re të punës për të shqyrtuar sa më mirë të gjitha çështjet që bien nën mandatin e tij. Ombudspersoni gjithashtu rriti kontaktet e tij me autoritetet në emër të individëve ose grupeve të cilët ballafaqoheshin me vështirësi për të cilat ishte e mundur të gjendet zgjidhja pa nevojë për hetime të gjata zyrtare (shih Aneksin 4). Institucioni gjithashtu përmirësoi raportet e punës me agjensione të ndryshme të UNMIK-ut dhe KFOR-it. Më 1 mars 2003, Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu themeloi një linjë telefonike urgjente për të gjithë individët që dëshirojnë ta kontaktojnë Institucionin përmes telefonit.

Si Ombudspersoni ashtu edhe zyrtarët e lartë të Institucionit morrën pjesë në një numër të trajnimeve, duke bërë bashkë autoritetet kompetente me përfaqësuesit e bashkësivë që ngritnin çështje në të cilat kërkoheshin veprime nga autoritetet qeveritare, për qëllim të ndihmës në përmirësimin e kushteve të jetës së përditshme të bashkësive në pozitë të pafavorshme në Kosovë. Për shembull, deri në fund të vitit shkollor 2001 – 2002, KFOR-i kishte ofruar përcjellje të armatosur për nxënës individualë ose për autobusë të shkollës në disa rajone etnikisht të përziera, siç janë për shembull Cërrnica (komuna e Gjilanit), komuna e Obiliqit, komuna e Vitisë, etj. Në fund të atij viti shkollor, KFOR-i ndërroi politikën e tij mbrojtëse në atë që të ofrojë vetëm mbrojtje të përgjithshme në zonat e prekura. Në përgjegjje ndaj brengave të shfaqura nga ana e disa prindërve serbë, Ombudspersoni ndihmoi për të siguruar që ekipe etnikisht të përziera të Shërbimit Policor të Kosovës të ofrojnë siguri adekuate për nxënësit në rrugën e tyre për në shkollë dhe prej saj.

Në fund të vitit 2002, Ombudspersoni ishte angazhuar për ta riaktivizuar furnizimin me ujë dhe energji elektrike në një ndërtesë në Fushë Kosovë, në të cilën ishin të vendosur familje serbe të zhvendosura brenda vendit, si dhe për ta riaktivizuar furnizimin me ujë në Janjina Voda, një fshat serb. Ai gjithashtu u angazhua për të ndihmuar përmirësimin e furnizimit me energji elektrike në rajonin e Llapje Sellës dhe kushteve të përgjithshme në kampine e

Plemetinit, popullsia e te cilit kryesisht përbëhet nga romët dhe ashkalitë. Ombudspersoni gjithashtu intervenoi te autoritetet që të sigurojnë naftë për ngrohje për dy qendra kolektive të të zhvendosurve brenda vendit në rajonin e Brezovicës. Ombudspersoni gjithashtu bëri përpjekje të mëdha për ta ndihmuar përmirësimin e kushteve të jetës së përditshme në tri fshatra shqiptare në komunën e Leposaviqit.

Në pranverë të vitit 2003, Ombudspersoni u angazhua për të ndihmuar zgjidhjen e problemeve, zgjidhja e të cilave kishte qenë baza për një grevë urie nga ana e studentëve të Univerzitetit të Prishtinës. Ai gjithashtu ndihmoi për të siguruar qasje për gazetarët që dëshironin të raportonin për grevën e urisë, në rastet kur qasja e tillë ishte mohuar nga ana e policisë vendore.

Gjithashtu në pranverë të vitit 2003, Ombudspersoni me sukses ndërmjetësoi në mes të një shoqate që përfaqësonte pronarët e bizneseve të vogla në Mitrovicë dhe autoriteteve komunale, në lidhje me nivelin e disa taksave të caktuara komunale mbi ato biznese. Si rezultat i këtij ndërmjetësimi, autoritetet vendosën ta zbresin nivelin e taksave për 50% dhe që kësaj zbritje t'i jipet efekt retroaktiv deri më datën e shpalljes së atij niveli.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ombudspersoni ka bërë dy vizita në Serbi, duke u takuar me zyrtarë qeveritarë, dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, siç janë Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur, Fondi për të Drejtën Humanitare ose Komiteti i Helsinkit në Serbi.

Në fillim të vitit 2003, pas një aktakuze të ngritur nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) kundër z. Agim Murtezi, një banori të Kosovës, KFOR-i e dërgoi atë në Tribunal. Një kohë të shkurtër pas kësaj, Tribunali gjeti që z. Murtezi që ishte sjellur pranë tij nuk ishte individ kundër të cilit ishte ngritur aktakuza, dhe ai u kthye në Kosovë. Duke pasur parasysh traumën e pësuar nga familja e tij dhe nga ai vetë, z. Murtezi iu drejtua Ombudspersonit për ta diskutuar mundësinë e marrjes së dëmshpërblimit dhe të një letre kërkimi ndjesë nga Tribunali. Në mënyrë që ta lehtësojë realizimin e këtyre kërkesave, Ombudspersoni shërbeu si ndërmjetësues mes z. Murtezi dhe një avokati kanadez i cili e kishte përfaqësuar pranë Tribunalit.

### **Përkrahja financiare dhe në të mira të tjera**

Sigurimi i fondeve për Institucionin e Ombudspersonit për vitin 2003 ishte ofruar nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, dhe donatorët e bashkuar në vijim: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Zvicra, Polonia, Suedia dhe Franca.

Këshilli i Evropës ofroi përkrahje të madhe për Institucionin, duke përfshirë ndihmën teknike dhe trajnimin për personelin administrative dhe juridik. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e lejoi një anëtar të personelit të Regjistrat t'i ofrojë Institucionit ekspertizë ligjore.

Zyrja e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/IDDNj) përkrahu vizitat e dy grupeve të anëtarëve të personelit, që i ishin bërë Ombudsmanit të Sllovenisë dhe Ombudsmanit të Polonisë.

Zyrja e Ombudsmanit të Norvegjisë e përkrahu vizitën e dy anëtarëve të personelit të saj si konsulltantë për Institucionin.

## **Prospektet për Institucionin e Ombudspersonit në të ardhmën**

Gjatë periudhës për të cilën raportohet dhe në lidhje me një seri të vendimeve mbi politikën të marra nga ana e UNMIK-ut, Institucioni i Ombudspersonit në masë të madhe zbriti numrin e personelit të tij ndërkombëtar, duke mbetur Ombudspersoni i vetmi ndërkombëtar në Institucion. Gjithashtu, diskutime janë bërë edhe në nivelet politike ndërkombëtare dhe vendore lidhur me “kosovarizimin” e plotë të Institucionit të Ombudspersonit deri në mes të vitit 2004. Edhe pse Ombudspersoni gjithmonë e ka përkrahur plotësisht “kosovarizimin” eventual të Institucionit, duket që veprimet që janë ndërmarrë në këtë veprim kanë qenë të ngutshme. Në veçanti, reduktimi drastik i angazhimit të punonjësve të kualifikuar profesional nga jashtë Kosovës ka ndikim negativ në efikasitetin e Institucionit. Gjatë kohës së shkurtër, tashmë kanë pësuar trajnimet intenzive që ishin në dispozicion të punonjësve vendorë të Institucionit, duke pasur implikime të qarta në kapacitetin e tyre për udhëheqje të Institucionit në të ardhmën. Në këtë kontekst, duket që nuk është marrë në konsiderim roli kyç i Institucionit si entiteti i vetëm i pavarur me mandat që të angazhohet në çështjet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit si me administratën ndërkombëtare, që do të mbetet në vend dhe në fuqi edhe pas asaj kornize kohore, ashtu edhe me institucionet vendore në ndërtim e sipër, që ende mbetet të zhvillohen plotësisht. Në këtë kontekst, një Ombuds Institucion i fortë me karakter hibrid ndërkombëtar dhe vendor garanton më së miri mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Marek Antoni Nowicki  
Ombudspersoni

**Annex 1: Përmbledhje statistikore e rasteve**

(30 korrik 2002 deri më 30 qershor 2003)

ÇËSHTJET E REGJISTRUARA PËRKOHËSISHT: **399**

PËRKATËSIA ETNIKE E PARASHTRUESVE TË KËRKESAVE:

Shqiptarë:	306
Serbë:	81
Të tjerë:	14

PALËT PËRGJEGJËSE:

UNMIK:	239
KFOR:	19
Institucionet e vetëqeverisjes së përkohshme:	63
Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore:	69
Të tjera:	44

ÇËSHTJET E SHPALLURA TË PAPRANUESHME: **69**

ÇËSHTJET E NDËRPRERA GJATË PROCEDURËS PËR ARSYE TJERA: **60**

HETIMET E HAPURA EX OFFICIO: **13**

REPORTET PËRFUNDIMTARE TË LËSHUARA: **10**

## **SUBJEKTI I LËNDËS SË APLIKACIONEVE ZYRTARE:**

Të drejtat lidhur me pronën:	156
Të drejtat lidhur me procesin e rregullt gjyqësor:	131
Keqpërdorimi i autoritetit:	56
Çështjet lidhur me punën:	37
Të drejtat në përfitime sociale dhe/ose standard adekuat të jetës:	28
E drejta në liri:	25
Liria nga trajtimi johuman dhe degradues:	19
Pandëshkueshmëria:	14
Të tjera (çështje që nuk janë të përfshira më lart dhe janë ngritur më pak se dhjetë herë) 13	

## **Aneksi 2: Përmbledhje e Kërkesave për Masa të Përkohshme**

(1 korrik 2002 – 30 qershor 2003)

**24 korrik 2002:** Kërkesë drejtuar PSSP-së për të ndërmarrë masa urgjente për të siguruar që një familje e madhe me shumë anëtarë të paaftë të mos largohet sipas një vendimi mbi largimin të DÇPB-së, më 25 qershor 2002, nga një banesë në Prishtinë ku ata ishin duke qëndruar, pasi që i vetmi strehim që ishte në dispozicion të kësaj familje gjendej jashtë Prishtinës dhe ishte larg nga përkujdesi themelor mjekësor dhe shërbimet tjera. Asnjë autoritet për mirëqenie social nuk i ishte përgjegjur kërkesave të familjes për ndihmë. Një kërkesë e dytë ishte dërguar më 26 korrik 2002, pasi që familja ishte dëbuar nga banesa.

(**E suksesshme:** Më 30 korrik 2002, zëvendësi kryesor i PSSP-së e informoi Ombudspersonin që familja ishte vënë në kontakt me autoritetet qeveritare vendore që janë përgjegjëse për ndarjen e vendeve në strehimoret e përbashkëta të përkohshme, dhe me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Social lidhur me zotësinë e tyre të mundshme juridike për shfrytëzimin e përfitimeve të mirëqenies sociale.)

**30 gusht 2002:** Kërkesë drejtuar PSSP-së për të ndërmarrë masa urgjente për të siguruar mbrojtjen pemishteve që gjendeshin në fshatin Morinë (një kërkesë e ngjajshme ishte dërguar edhe më 8 maj 2002) (Këto kërkesa gjithashtu ishin përmendur në letrën e Ombudspersonit të datës 17 shtator 2002, drejtuar PSSP-së) (shih më poshtë.)

(**E pasuksesshme:** nuk ka pasur përgjegjje).

**17 shtator 2002:** Kërkesat e pazgjidhura për masa të përkohshme të përmendura në një letër drejtuar PSSP-së, e cila ofronte një përmbledhje të çështjeve që ishin ngritur me të ose me paraardhësit e tij dhe në lidhje me të cilat kishte pasur përgjegjje joadekuate apo nuk kishte pasur përgjegjje fare (shih Aneksin 4):

Dy kërkesa për masa të përkohshme (3 korrik 2001 and 3 prill 2002) në rastin “Trepça” (duke kërkuar nga PSSP-ja të ndalë shitjet e UNMIK-ut të pronave, pronësia e të cilave kontestohet pranë Gjykatës Ekonomike në Prishtinë)

(**E pasuksesshme:** nuk ka pasur përgjegjje).

**26 nëntor 2002:** Kërkesë Zyrës së UNMIK-ut për Kthime dhe Komunitete për të ndërmarrë veprime urgjente për të siguruar që shkollave në Osojan, komuna e Istogut, dhe Kolloni, komuna e Gjakovës, të u ofrohet ngrohje adekuate.

(**e suksesshme**)

**29 nëntor 2002:** Kërkesë PSSP-së që të ushtrojë autoritetin e tij për të ndalur ndërtimet që ishin duke u kryer nga ana e KEK-ut në një numër të pronave që gjendeshin në Prishtinë, në pritje të vendimit të prerë të gjykatës në rastet përkatëse civile.

(**pjesërisht e suksesshme:** më 14 janar 2003, PSSP e informoi Ombudspersonin që PSSP-ja kishte konsideruar që do të ishte e papërshatshme që ai të urdhërojë ndaljen e ndërtimit në bazë të asaj që ndërtimet e tilla ishin të nevojshme për t’u ofruar energji elektrike banorëve të asaj zone dhe që KEK-u kishte shprehur gatishmërinë për të paguar komenzim për çfarëdo dëmi të shkaktuar, në pajtim me vendimin gjyqësor përkatës) [Në fund, palët e zgjidhën rastin]

**4 shkurt 2003:** Kërkesë drejtorit të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) që gjatë periudhës së dimrit të pezullojë largimin e një numri të familjeve nga pronat në të cilat ata ishin duke qëndruar ilegalisht në rajonin e Pejës, pa u ofruar atyre strehim tjetër.

(**Në përgjegjjen e datës 14 shkurt 2003, DÇPB përshkroi rrugët e mundshme për familjet të cilat do të mbeteshin pa strehim në rast të largimit nga pronat në të cilat ishin duke qëndruar ilegalisht, dhe theksoi që familjet në fjalë nuk i kishin shfrytëzuar këto rrugë**)

**16 prill 2003:** Kërkesë kryetarit të Gjykatës komunale në Prishtinë të ndërmarrë veprime urgjente për ta parandaluar tjetërsimin e pronës së përbashkët të një çifti të shkurorëzuar, në pritje të vendimit të prerë mbi pronën përmes procedurës gjyqësore.

(e **suksesshme:** Kryetari i Gjykatës komunale i siguroi Ombudspersonit një kopje të urdhërit të saj me të cilin ndalohej tjetërsimi ose përdorimi i pronës për qëllime përfitimi në rastin në fjalë)

**5 maj 2003:** Kërkesë ushtruesit të detyrës së drejtorit të Departamentit për Sport dhe Kulturë në Gjilan për të ndërmarrë veprime urgjente për të siguruar të gjitha librat në gjuhën serbe që atëherë gjendeshin nën përkujdesje dhe kontroll të Bibliotekës së qytetit në Gjilan, dhe për të siguruar që asnjë libër i tillë të mos dëmtohet apo zhvendoset nga ai vend.

(e **suksesshme:** Autoritetet përgjegjëse e informuar Ombudspersonin lidhur me praktikatat e tyre të përgjithshme dhe veprimet e tyre për të siguruar mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e duhur të të gjitha koleksioneve të bibliotekave brenda zonës së përgjegjesisë së tyre.)

**20 Maj 2003:** Kërkesë kryetarit të Gjykatës komunale në Prizren për të urdhëruar Drejtorinë për Planifikimim dhe Urbanizëm në Suharekë të pezullojë lejet e ndërtimit dhe të sigurojë që të ndalen të gjitha ndërtimet në pronat, pronësia e të cilave ishte lëndë në procedurës gjyqësore në pritje për t'u zgjidhur (Si Drejtoria, ashtu edhe personi të cilit i ishte lëshuar leja e ndërtimit ishin palë në procedurën gjyqësore)

(E **pasuksesshme:** nuk ka pasur përgjegjje).

**2 qershor 2003:** Duke pasur parasysh mungesën e përgjegjjes në kërkesën e mëparshme, Ombudspersoni kërkoi nga PSSP-ja që të ndërmarrë masa urgjente për të urdhëruar Drejtorinë për Planifikimim dhe Urbanizëm në Suharekë të pezullojë lejet e ndërtimit që i kishte lëshuar me të cilat lejonte punët e ndërtimit në pronat që ishin lëndë në procedurën gjyqësore në të cilën ishin palë si Drejtoria Komunale ashtu edhe personi që i kishte marrë lejet e ndërtimit, dhe gjithashtu për të siguruar që të gjitha punët e ndërtimit të ndalen menjëherë. [Ombudspersoni gjithashtu kishte rekomanduar që të fillohet procedura disiplinore kundër Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm në Suharekë]

(E **pasuksesshme:** nuk ka pasur përgjegjje).

### Aneksi 3: Përmbledhjet e raporteve

#### **PËRMBLEDHJE**

Nr. i Regjistrimit *ex officio* 12/01

Lidhur me zhvillimin e procedurës penale  
kundër

Z. Alexandar Zotov dhe z. Marat Akhamadiyarov

28 janar 2003

Në këtë rast, Ombudspersoni hetoi pohimet që dy shtetas rus ishin privuar nga të drejtat e caktuara të garantuara me nenin 5 dhe 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut gjatë zhvillimit të procedurave kundër tyre. Ombudspersoni gjeti që individët në fjalë ishin informuar për arsyet e arrestimit të tyre me kohë dhe në gjuhën e tyre amtare ruse, prandaj nuk kishte pasur shkelje të së drejtës për tu informuar drejtë, në një gjuhë të cilën ata e kuptojnë, për arsyet e arrestimit të tyre dhe për çdo akuzë drejtuar kundër tyre, siç është garantuar në nenin 5(2) të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Ombudspersoni vëren se të akuzuarve në këtë rast iu është siguruar një kopje me shkrim e padisë në gjuhën Shqipe por që ishte përkthyer oralisht në gjuhën ruse dy javë më vonë, kurse përkthimi me shkrim i padisë në gjuhën ruse u ishte siguruar dhjetë ditë pas kësaj. Prandaj, Ombudspersoni gjeti se në padi nuk ka pasur shkelje të së drejtës së individëve në fjalë për tu informuar drejtë për akuzat kundër tyre, në një gjuhë të cilën e kuptojnë, siç është garantuar në nenin 6 (3)(a) të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Ombudspersoni gjeti që edhe pse avokati mbrojtës për herë të parë u takua me të akuzuarit më 25 prill 2001 dhe formalisht u caktua në detyrë më 3 maj 2001, në të njëjtën ditë kur gjykimi kishte qenë dashur të filloi, gjykata kompetente u përgjegj pozitivisht në kërkesën e avokatit mbrojtës për ta shtyrë gjykimin për të mundur të sigurojë kohën e nevojshme për ta përgatitur mbrojtjen në mënyrë të duhur. Prandaj Ombudspersoni konkludoi se nuk ka pasur shkelje të së drejtës për kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes siç është garantuar në nenin 6(3)(b) të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Më tutje, Ombudspersoni gjeti që gjykata komunale kishte emëruar një avokat mbrojtës pa pagesë për të akuzuarit dhe që avokatët mbrojtës kishin përmbushur obligimet e tyre profesionale me atë që kishin përfaqësuar të akuzuarit në mënyrë të duhur. Prandaj, Ombudspersoni konkludoi se nuk kishte pasur shkelje të së drejtës për ndihmë ligjore pa pagesë siç është e garantuar me nenin 6(3)(c) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në fund, Ombudspersoni gjeti që një përkthyes shqip – rusisht ishte siguruar nga ana gjykatës komunale për të dy takimet me gjykatësin hetues dhe gjatë seancës kryesore mbi rastin. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të së drejtës që të ketë ndihmën e përkthyesit pa pagesë siç është e garantuar me nenin 6(3)(e) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



## PËRMBLEDHJE

Nr. i Regjistrimit *ex officio* 14/01

Lidhur me trajtimin e përfaqësuesit të Fondit për të Drejtën Humanitare nga zyrtarët e burgut në Mitrovicë

30 janar 2003

Në këtë rast Ombudspersoni hetoi pohimet që Drejtori i Qendrës së paraburgimit në Mitrovicë kishte refuzuar ta lejojë një përfaqësues të Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH), një organizatave joqeveritare, për të vizituar pesë të paraburgosur me rastin e paraqitjes së këtij përfaqësuesi në Qendrën e paraburgimit, dhe që zyrtarët e Qendrës së paraburgimit i kishin kopjuar të dhënat rreth vizitave të mëparshme në Qendrën e paraburgimit nga kompjutori “lap top” i përfaqësuesit të FDH-së pa pëlqimin e tij. Edhe pse faktet lidhur me refuzimin fillestar të lejimit të përfaqësuesit të FDH-së t’i vizitojë të paraburgosurit në Qendrën e paraburgimit në Mitrovicë nuk janë të pakontestueshme, nuk ishte e mundur të vërtetoheshin faktet lidhur me pohimet që zyrtarët e Qendrës së paraburgimit i kishin kopjuar të dhënat rreth vizitave të mëparshme në Qendrën e paraburgimit nga kompjutori “lap top” i përfaqësuesit të FDH-së pa pëlqimin e tij. Prandaj, Raporti nuk kishte shqyrtuar mundësinë e shkeljes së të drejtave të njeriut apo keqpërdorimin e autoritetit lidhur me atë çështje.

Ombudspersoni vërejti që ligji relevant vendor i lejon të paraburgosurit të kërkojnë nga gjykata kompetente që të autorizojë përfaqësuesit e organizatave joqeveritare për t’i vizituar, dhe që përfaqësuesi i FDH-së ishte i autorizuar ta bëjë atë. Ombudspersoni gjithashtu vërejti që dispozita e njejtë e ligjit që përcakton kërkesat e autorizimit gjithashtu vendos që vizitat e autorizuara duhet të bëhen në pajtim me rregullat e brendshme të qendrës së paraburgimit. Lidhur me këtë, Ombudspersoni më tutje vërejti që drejtori kishte refuzuar që përfaqësuesi i FDH-së të ketë qasje të menjëhershme te të paraburgosurit që është në pajtueshmëri me rregullat e brendshme të Qendrës së Paraburgimit dhe rregullat e Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas të cilave kërkohet që përfaqësuesit e OJQ-ve që të marrin leje nga autoritetet e burgut 24 orë para vizitës së planifikuar. Ombudspersoni gjithashtu vërejti që në rastin në fjalë drejtori kishte kërkuar nga përfaqësuesi i FDH-së të kthehej më vonë gjatë të njejtës ditë, në mënyrë që drejtori të kishte mundësinë të konsullohej me autoritete më të larta lidhur me lejimin e asaj vizite. Po të kishte vendosur përfaqësuesi i FDH-së ta bënte këtë, vizita do të ishte lejuar.

Prandaj, Ombudspersoni gjeti që refuzimi fillestar në kërkesën e përfaqësuesit të FDH-së për t’i vizituar të paraburgosurit në Qendrën e paraburgimit në Mitrovicë nuk kishte përbërë shkelje të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autoritetit.

## PËRMBLEDHJE

Lidhur me kohëzgjatjen e procedurës në rastin e Alush Krasniqit

31 janar 2003

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Komunale për të ia dorëzuar aktgjykimin palës së pandehur mes 28 marsit 2001 dhe 13 qershorit 2001, së bashku me dështimin e Gjykatës së Qarkut për të ndërmarrë ndonjë veprim në këtë rast në mes 18 korrikut dhe 7 majit 2002, kishin përbërë shkelje të së drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është garantuar në par. 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu gjeti që mungesa e çfarëdo mënyre specifike ligjore përmes së cilës aplikanti do të kishte mundur të ankohet për zgjatje të procedurës me çfarëdo parashikimi apo shprese për ta arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompenzimit kishte përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për mjete efektive të garantuar me nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të duhej që, jo më vonë se më **28 mars 2003**, të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në gjykatat e Pejës/Pec apo të ndërmarrë masa tjera të nevojshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjyqimeve të të gjitha palëve brenda një kohe të arsyeshme dhe të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që ofron zgjidhje si në formë parandalimi ashtu edhe në formë kompenzimi lidhur me ankesat rreth zgjatjes së procedurës në rastet civile.

**Më 7 shkurt 2003, zëvendësi i PSSP-së për Drejtësi dhe Polici e informoi Ombudspersonin që rekomandimet e këtij Raporti i ishin përcjellur Departamentit të Drejtësisë në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për vëmendjen dhe konsideratën e tyre. Ai gjithashtu shtoi që ky i fundit ishte në proces të rishqyrtimit të shpërndarjes dhe kapacitetit të personelit në gjykatat e Kosovës, në mënyrë që të sigurojë baraspeshë adekuat në mes të ngarkesës me raste dhe kapacitetit të personelit në atë masë sa lejojnë kufizimet buxhetore.**

## PËRMBLEDHJE

Milomir Mitrović  
kundër  
Gjykatës Komunale në Ferizaj/Urosevac

26 mars 2003

Në këtë Raport, Ombudspersoni gjeti që, për të gjitha qëllimet, rrethanat e rastit në fjalë nuk mund të dalloheshin në kurrfarë mënyre nga ato të shqyrtuara në Raportin e Ombudspersonit të datës 22 prill 2002 (shih përmbledhjen në Raportin e Dytë Vjetor në par. 43-44). Si rrjedhim, analizat ligjore të përmbajtura në atë raport gjithashtu vlejné edhe për faktet e këtij rasti. Ombudspersoni gjeti që refuzimi i administratores komunale në Fushë Kosovë/Kosovo Polje për ta lejuar Gjykatën komunale ta regjistrojë kontratën për shitblerje të pronës së banimit, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/17 kishte përbërë shkelje të të drejtave në vijim: të drejtën për respektimin e pasurisë (neni 1 i Protokolit shtesë të Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut); të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare dhe për respektimin e vendbanimit (neni 8 i Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut); të drejtën për të zgjedhur vendbanimin, të garantuar me (neni 2 i Protokolit nr. 4 të Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut); të drejtën për të qenë i lirë nga diskriminimi (neni 14 i Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut); të drejtën për të qenë i lirë nga vendosja e kufizimeve në të drejtat për qëllime tjera nga ato të përcaktuara me Konventë (neni 18 i Konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut). Ombudspersoni gjithashtu përsëriti shqetësimet e theksuara në lidhje me Raportin Special nr. 5 mbi aspekte të caktuara të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/17 mbi Regjistrimin e kontratave për shitjen e patundshmërive në zonat e veçanta gjeografike të Kosovës (22 gusht 2001) drejtuar Z. Hans Haekkerup, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (29 Tetor 2001). Ombudspersoni gjithashtu gjeti që zbatimimi i një Rregulloreje që më parë ishte gjetur të jetë në kundërshtim me standardet e pranuar ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut kishte përbërë keqpërdorim të autoritetit nga ana e administratores komunale në Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

Ombudspersoni rekomandoi që, jo më vonë se më **4 prill 2003**, Përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm do të duhej të vepronte në baza urgjente për të siguruar që kontrata mbi shitjen e pronës në fjalë të z. Mitrović të regjistrohet nga ana e gjykatës kompetente në Kosovë, dhe që, jo më vonë se më **11 prill 2003**, të çfuqizojë Rregullorën e UNMIK-ut 2001/17, të çfuqizojë Udhëzimin administrativ 2001/16 që implementon Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2001/17 (19 tetor 2001), të çfuqizojë Udhëzimin administrativ 2002/4 që implementon Rregullorën e UNMIK-ut nr. 2001/17 (28 shkurt 2002), të çfuqizojë çfarëdo Udhëzimi administrativ shtesë apo akte tjera nënligjore që për qëllim kanë zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/17, të leshojë një Udhëzim Administrativ të ri me të cilin do të anulonte çfarëdo vendimi me të cilin refuzohet regjistrimi i kontratës së shitjes së patundshmërisë kudo në Kosovë, i marrë në pajtim me Rregullorën e UNMIK-ut. 2001/17 dhe Udhëzimin Administrativ 2001/16, 2002/4 apo çfarëdo Udhëzimi administrativ përkatës apo akte tjera vartëse ligjore, të informojë të gjitha gjykatat në Kosovë mbi veprimet e mësipërme t'i udhëzojë ato që të regjistrojnë çfarëdo kontrate të shitjes së patundshmërisë që nuk është regjistruar si rezultat i implementimit të Rregullores së UNMIK-ut 2001/17.

**Më 11 prill 2003, zëvendësi kryesor i Përfaqësuesit Special e informoi Ombudspersonin që administratorja komunale në Fushë Kosovë/Kosovo Polje kishte vepruar jashtë kompetencave të saj duke refuzuar ta lejojë regjistrimin e shitblerjes së pronës në fjalë, pasi që ajo pronë nuk gjendej në zonën gjeografike në të cilën është e zbatueshme Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/17. Ai theksoi që kontrata e shitblerjes së asaj pronë do të regjistrohej si duhet.**

## PËRMBLEDHJE

Lidhur me kohëzgjatjen e procedurës në rastin e Zarife Haxhollit

11 prill 2003

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Komunale në Glllogovc për të vendosur mbi rastin e saj civil prej 22 majit 2001 e deri më datën e këtij Raporti, së bashku me dështimin e Gjykatës Komunale për të ndërmarrë ndonjë veprim ose për të mbajtur ndonjë seancë në këtë rast në mes 22 majit 2001 dhe 23 tetorit 2002, përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është garantuar në par. 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu gjeti që mungesa e çfarëdo mënyrë specifike ligjore përmes së cilës aplikantja do të kishte mundur të ankohet për zgjatje të procedurës me çfarëdo parashikimi apo shprese për ta arritur çfartëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompenzimit kishte përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për mjete efektive të garantuar me nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Ombudspersoni rekomandon që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të duhej që, jo më vonë se më **25 prill 2003**, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që Gjykata Komunale në Glllogovc të përfundojë procedurën në rastin konkret pa vonesë të mëtutjeshme, dhe të nxjerrë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe që ofron zgjidhje si në formë parandalimi ashtu edhe në formë kompenzimi lidhur me ankesat rreth zgjatjes së procedurës në rastet civile;

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë Raport.**

## PËRMBLEDHJE

Gani Thaçi  
kundër  
Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë  
(UNMIK)

17 prill 2003

Në fillim të shqyrtimit të këtij rasti, që kishte të bëjë me suspendimin dhe më vonë përjashtimin e aplikantit nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), Ombudspersoni gjeti që natyra e detyrave dhe përgjegjësi të pjesëtarëve të TMK-së, shikuar në kuptim të kritereve të themeluara nga ana e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut për zbatueshmërinë e nenit 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, e kishte vendosur procedurën rreth suspendimit dhe përjashtimit të pjesëtarëve të TMK-së brenda spektrit të këtij neni.

Ombudsperson vërejtë që TMK-ja, organet disiplinore të TMK-së dhe PSSP-ja (në kapacitetin e tij si autoriteti më i lartë administrativ mbi çështjet e TMK-së) kishin dështuar të përgjegjen në kërkesat e përsëritura të aplikantit si për të iu siguruar një vendim i arsyetuar me shkrim mbi përjashtimin e tij nga TMK-ja, ashtu edhe për ta shqyrtuar ankesën e tij kundër suspendimit. Gjykata kompetente ishte deklaruar përmes vendimit zyrtar që nuk ishte në gjendje të shqyrtojë rastin deri sa të mos shfrytëzoheshin të gjitha kanalet e shqyrtimit administrativ, duke përfshirë edhe vendimin e PSSP-së. Gjykata sypreme, që ka juridikcion ta urdhërojë PSSP-në të leshojë vendimin me shkrim të kërkuar me ligj, gjithashtu kishte dështuar të ndërmarrë veprimin përkatës. Ombudspersoni gjeti që dështimi total i të gjitha autoriteteve administrative për t'u pajtuar me obligimet e tyre ligjore që të ia sigurojnë aplikantit një vendim të arsyetuar me shkrim ia kishte pamundësuar aplikantit që rasti i tij të shqyrtohej në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe parimet e sundimit të ligjit. Prandaj, ka pasur shkelje të të drejtës së z. Thaçit për një proces të rregullt të garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përveç pretendimeve që të drejtat e tij sipas nenit 6 të Konventës ishin shkelur, aplikanti në këtë rast konsideroi që suspendimi dhe më vonë përjashtimi i tij nga TMK-ja duket të kishin qenë në masë të madhe të bazuar në deklaratat që ai i kishte dhënë shtypit lidhur me ndikimin negativ që e kishin pasur te ai aktvendimet e brendshme të personelit dhe veprimet e ndërmarra nga ana e TMK-së, dhe me këtë ishte bërë pasur shkelja të të drejtës së z. Thaçit për lirinë e shprehjes të garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, Ombudspersoni, mes tjerash, gjeti që ndikimi i këtyre veprimeve në disiplinën e TMK-së mund të kishte pasur efekt aq të madh sa për të sjellur deri te shqiptimi i masave disiplinore kundër tij, dhe që veprimet që janë ndërmarrë në këtë drejtim nuk mund të konsideroheshin të kishin qenë joproporcionale. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të të drejtës së z. Thaçit për lirinë e shprehjes të garantuar me nenin 10 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP-ja, jo më vonë se më 16 maj 2003, të sigurojë që autoritetet kompetente administrative të ia lëshojnë aplikantit vendimet e arsyetuara me shkrim mbi përjashtimin e tij nga TMK-ja, si dhe të marrin mbi vete të marrin pjesë plotësisht në çfarëdo procedurash gjyqësore që do të mund të lindin pas përfundimit të procesit rezultues të shqyrtimit administrativ, në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe vendimet e Gjykatave të Qarkut relevante të cituara në Raport.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë Raport.**

## **PËRMBLEDHJE**

Afrim Selaci  
kundër  
Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë  
(UNMIK)

17 prill 2003

Në këtë rast, aplikanti ishte ankuar që ai ishte keqtrajtuar nga Policia e UNMIK-ut, në kundërshtim me të drejtat e tij sipas nenit 3 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Në Raportin e tij mbi rastin, Ombudspersoni vërejti që autoritetet e UNMIK-ut kishin refuzuar për më shumë se dy vjet të përgjegjjen ndaj kërkesave të Ombudspersonit për çfarëdo informata relevante që ato i posedonin lidhur me rastin, edhe pse informatat që ato në fund i ofruan qartas tregonin se nuk kishte pasur sjellje të keqe nga ana e Policisë së UNMIK-ut. Ombudspersoni kishte kërkuar këto informata në tetë raste të ndryshme pas fillimit të procedurës penale kundër aplikantit për sulm ndaj një pjesëtari të policisë gjatë incidentit në fjalë. Shtatë nga këto kërkesa ishin bërë pasi që aplikanti ishte dënuar për kundërvajtjen dhe pasi që aktgjykimi, një dokument publik, ishte lëshuar. Ombudspersoni konsideroi që kokëfortësia e autoriteteve të UNMIK-ut për të refuzuar përgjegjjen ndaj kërkesave për informata mbi rastin, ngriste shqetësime serioze lidhur me standardin e transparencës që konsiderohet të jetë adekuat në operacionet e pretenduara demokratike të policisë në Kosovë.

Ombudspersoni konkludoi që nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo të ndonjë dispozite tjetër relevante mbi të drejtat e njeriut.

## PËRMBLEDHJE

Haki Sahiti  
kundër  
Gjykatës Komunale në Ferizaj/Urosevac

21 prill 2003

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj/Urosevac për ta ekzekutuar vendimin e prerë të 11 majit 1998 në favor të aplikantit kishte përbërë shkelje të të drejtës për një proces të rregullt të garantuar me nenin 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Ai gjithashtu gjeti që dështimi i gjykatës për të marrë ndonjë vendim lidhur me pjesën e rezervuar të aktgjykimit prej 25 nëntorit 1997 (data e aktgjykimit) e deri në datën e Raportit të Ombudspersonit kishte përbërë shkelje të së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor të garantuar me par.1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu gjeti që mungesa e çfarëdo mënyrë specifike ligjore përmes së cilës aplikanti do të kishte mundur të ankohet për zgjatje të procedurës qoftë në ekzekutim të aktgjykimit apo vendosje përfundimtare të çështjeve të pazgjidhura, me çfarëdo parashikimi apo shprese për ta arritur lehtësim në formë të parandalimit apo kompenzimit, kishte përbërë shkelje të të drejtës së aplikantit për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ombudspersoni rekomandoi që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të duhej që, jo më vonë se më **16 maj 2003**, të ndërmarrë hapa urgjent që të sigurojë se pjesa përmbartuese e aktgjykimit të 25 nëntorit 1997 të Gjykatës Komunale në Ferizaj/Urosevac të ekzekutohej tërësisht pa ndonjë vonesë të mëtutjeshme, të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme që të sigurojë që Gjykata Komunale në Ferizaj/Urosevac të shqyrtojë të gjitha çështjet e pazgjidhura nga aktgjykimi i 25 nëntorit 1997 dhe të lëshojë një aktgjykimi mbi këto çështje pa ndonjë vonesë të mëtutjeshme, dhe të nxjerrë një Rregullore që ofron ankim efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila ofron lehtësim në formë të parandalimit dhe kompenzimit në lidhje me ankesat për të drejtën për proces të rregullt dhe zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë Raport.**

## PËRMBLEDHJE

Lidhur me kohëzgjatjen e procedurës në rastin e Gordana Ilioska-Đorić

23 prill 2003

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që dështimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë/Pristina për vendosur mbi rastin e saj prej 15 shtatorit 1998 e deri më datën e Raportit, së bashku me dështimin e Gjykatës Komunale për të ndërmarrë ndonjë veprim apo mbajtur ndonjë seancë në këtë rast në mes 15 shtatorit 1998 dhe 11 marsit 2003, kishin përbërë shkelje të së drejtës së saj për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor, siç është garantuar në par. 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni gjithashtu gjeti që mungesa e çfarëdo mënyre specifike ligjore përmes së cilës aplikantja do të kishte mundur të ankohet për zgjatje të procedurës me çfarëdo parashikimi apo shprese për ta arritur çfartëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompenzimit kishte përbërë shkelje të së drejtës së aplikantit për mjete efektive të garantuar me nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Ombudspersoni rekomandon që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të duhej që, jo më vonë se më **16 maj 2003**, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që Gjykata Komunale në Prishtinë/Pristina të përfundojë procedurën e saj pa vonesë të metutjeshme dhe të lëshojë një Rregullore që siguron një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe që ofron zgjidhje si në formë parandalimi ashtu edhe në formë kompenzimi lidhur me ankesat rreth zgjatjes së procedurës në rastet civile;

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë Raport.**



## PËRMBLEDHJE

Afrim Zeqiri  
kundër  
Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

30 maj 2003

Në këtë rast, Ombudspersoni gjeti që aspekte të ndryshme të privimeve të lirisë së aplikantit z. Afrim Zeqiri nga 29 maji 2000 deri më datën e këtij Raporti kishin qenë të paligjshme në kuptim të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ato aspekte përfshinin privimin e lirisë së aplikantit të vendosur nën një seri të “Urdhërave ekzekutiv” të lëshuar nga PSSP-ja, paraburgimin e tij fillestar, privimin e lirisë së tij sipas disa vendimeve të gjykatave kompetente dhe, në fund, privimin e lirisë së tij për periudha kohore për të cilat nuk kishte pasur as Urdhëra ekzekutiv as vendime valide gjyqësore.

Ombudspersoni gjithashtu gjeti që dështimi i autoriteteve për ta dërguar aplikantin para autoritetit kompetent gjyqësor prej 29 majit 2000 deri më 2 qershor 2000, dhe mungesa totale e çfarëdo mundësie për ta kontestuar paraburgimin e tij nën Urdhërat ekzekutiv kishin përbërë shkelje të të drejtës së tij për t’u dërguar menjëherë para një autoriteti të tillë, siç është e garantuar me par. 3 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni në fund gjeti që dështimi i autoriteteve kompetente gjyqësore, prej 2 qershorit 2000 deri më 25 janar 2002, për ta konsideruar mundësinë e lirimit të aplikantit nga paraburgimi duke e kushtëzuar këtë me garanci që siguron paraqitjen para gjyqit kishte përbërë edhe një shkelje të të drejtave të aplikantit sipas par. 3 të nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Lidhur me të drejtën e aplikantit për gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar ligjërisht, të garantuar sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Ombudspersoni gjeti që shpallja dhe implementimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/2, e cila i jipte pushtet të gjërë Prokurorit ndërkombëtar të ngarkuar me rastin, kishte ndryshuar në masë të madhe rregullat që qeverisnin zhvillimin e procedurës kundër aplikantit. Prandaj, me këtë rast kishte pasur shkelje të të drejtave të tij sipas asaj dispozitë të Konventës.

Ombudspersoni rekomandoi që PSSP-ja, **jo më vonë se më 30 qershor 2003**, të pajtohet me rekomandimet e theksuara në Raportin Special nr. 3 dhe të përsëritura në Raportin Special nr. 4, të nxjerrë një rregullore të UNMIK-ut që shfuqizon rregulloren e UNMIK-ut 2001/2 mbi ndryshimet e rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2000/6, mbi emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtar (12 janar 2001), dhe që në ditën hyrjes së tyre në fuqi, të përhapë nëpërmjet të gjithë kanaleve përkatëse Rregulloret e reja të UNMIK-ut në të gjitha gjuhët që përdoren në Kosovë, në pajtim me nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1. Në veçanti, Rregullorja duhet të i shpërndalet të gjithë gjyqtarëve, zyrtarëve gjyqësor ose të tjerëve të cilët ushtrojnë autoritet gjyqësor në Kosovë, si dhe të gjithë individëve të paraburgosur.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë Raport.**

## **Aneksi 4: Përmbledhjet e letrave të zgjedhura me të cilat kërkohet ndihmë ose shërbime**

**(1 korrik 2002 – 30 qershor 2003)**

**17 shtator 2002:** Letër PSSP-së duke kërkuar informata lidhur me veprimet që UNMIK-u i kishte ndërmarrë apo planifikonte t'i ndërmarrë në mënyrë që të zgjidhen një numër i çështjeve të pazgjidhura (Kjo letër kishte për qëllim të ofrojë një përmbledhje gjithëpërfshirëse të çështjeve që ishin ngritur gjatë mandatit të PSSP-së së mëparshëm). Çështjet që kanë të bëjnë me kërkesa për masa të përkohshme janë të përfshira në Aneksin 2.

PSSP u përgjegj në çështjet vijuese që ishin ngritur në letrën e Ombudspersonit të datës 17 shtator 2002:

Nuk kishte pasur përgjegje në letrën drejtuar PSSP-së (29 janar 2002) lidhur me mungesën e qasjes së shqiptarëve kosovarë në dokumentet civile që mbahen në Serbi.

**Më 9 tetor 2002, PSSP e informoi Ombudspersonin lidhur me dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet tjera që duhet të përmbushen si kushte që UNMIK-u të lëshojë dokumentet civile që përndryshe do të duhej të merreshin në Serbi.**

Deri më 30 qershor 2003, nuk ka pasur përgjegje adekuate në çështjet vijuese që ishin ngritur në letrën e Ombudspersonit të datës 17 shtator 2002:

Raporti Special Nr. 1 Mbi pajtushmerinë e standardeve të njohura ndërkombetare me Rregullorën e UNMIK –ut Nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e UNMIK-ut dhe KFOR-it dhe personelit të tyre (18 gusht 2000) dhe zbatimin e rregullorës së lartpërmendur

**Në verë të vitit 2001, PSSP i mëparshëm e informoi Ombudspersonin që Raporti i tij “ishte dërguar në Nju Jork”.**

Raporti në rastin V.S. dhe V.N. kundër UNMIK-ut (29 janar 2002)

**Më 12 mars 2003, PSSP e informoi Ombudspersonin që hetimet mbi këto vrasje ishin zhvilluar por pa gjetur ndonjë provë lidhur me identitetin e kryerësve të veprave penale. Ai gjithashtu shtoi që policia ishin duke vazhduar kërkimet e tyre për dëshmitarë të ri dhe që do ta informonte Ombudspersonin për çfarëdo përparimi që do të bëhej lidhur me rastet.**

Raporti Special nr. 5 mbi aspekte të caktuara të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/17 mbi Regjistrimin e kontratave për shitjen e patundshmërive në zonat e veçanta gjeografike të Kosovës (22 gusht 2001) dhe Raporti mbi rastin *ex officio* 24/2002 lidhur me refuzimin e UNMIK-ut për ta regjistruar një kontratë të shitblerjes së një prone të banimit në Lipjan

**Më 9 tetor 2002, PSSP e informoi Ombudspersonin që kurrafrë veprime nuk ishin ndërmarrë ose ishin duke u marrë në konsiderim as për ta ndryshuar Rregulloren, as implementimin e saj.**

Deri më 30 qershor 2003, nuk ka pasur informata shtesë lidhur me çështjet vijuese që ishin ngritur në letrën e Ombudspersonit të datës 17 shtator 2002:

Në përgjegje ndaj rekomandimeve të Ombudspersonit në rastin *A.P.L.* (17 tetor 2001), UNMIK-u theksoi që do të:

- Përmirësonte formularët e kërkesës për paraburgim për të siguruar që në rastet kur organi i punëve të brendshme e konsideron të nevojshme që dikush të paraburgoset për më gjatë se 24 orë pas arrestimit, çfarëdo periudhe e tillë e gjatë të arsyetohet me shkrim, t'i sigurohet njoftimi të paraburgosurit, si dhe që paraburgimi të jetë në pajtim me dispozitat e aplikueshme të Ligjit mbi Procedurën penale.

Në përgjegje ndaj rekomandimeve të Ombudspersonit në rastin *Rashica* (31 tetor 2001), PSSP-ja theksoi që do të:

- sillte rastin në vëmendje të ushtruesit të detyrës së Komesarit të Policisë së UNMIK-ut, duke kërkuar bashkëpunim të plotë nga Policia e UNMIK-ut për të siguruar që veprimet përkatëse ligjore do të mund të ndërmirren për të ju drejtuar çfarëdo veprave penale që mund të jenë kryer;

- kërkonte ndihmën e ZPSSP-së për Drejtësi dhe Polici për të ja përcjellë rastin një prokurori publik ndërkombëtar për vëmendjen e tij;
- përcillte rastin Bordit të UNMIK-ut për Shqyrtim të Kërkesave për të vendosur nëse aplikantit i takon kompenzimi.

Në përgjegjje ndaj rekomandimeve të Ombudspersonit në rastin *Maliqi* (13 mars 2001), PSSP-ja theksoi që do të:

- sillte rastin në vëmendje të ushtruesit të detyrës së Komesarit të Policisë së UNMIK-ut, duke kërkuar bashkëpunim të plotë nga Policia e UNMIK-ut për të siguruar që veprimet përkatëse ligjore do të mund të ndërmerren për të ju drejtuar çfarëdo veprave penale që mund të jenë kryer;
- përcillte rastin Bordit të UNMIK-ut për Shqyrtim të Kërkesave për të vendosur nëse aplikantit i takon kompenzimi.

Deri më 30 qershor 2003, nuk ka pasur kurrfarë përgjegjje lidhur me çështjet vijuese që ishin ngritur në letrën e Ombudspersonit të datës 17 shtator 2002:

Raporti në rastin R.C. kundër UNMIK-ut (29 janar 2002)

Raporti në rastin S.A. kundër UNMIK-ut (29 janar 2002)

Raporti në rastin S.B. kundër UNMIK-ut (29 janar 2002)

Raporti Special nr. 3 mbi pajtueshmërinë e privimit të lirisë sipas “Urdhërave Ekzekutiv” me standardet e njohura (29 qershor 2001)

Raporti Special nr. 4 mbi aspektet e caktuara të Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/18 mbi krijimin e Komisionit për shqyrtimin e paraburgimit për paraburgimet jashtëgjyqësore të bazuara mbi Urdhëresat Ekzekutive (25 gusht 2001)

Tri kërkesa PSSP-së (7 mars 2001, 20 prill 2001 dhe 8 maj 2002) për të intervenuar te autoritetet kompetente në Beograd për të siguruar që individët në Kosovë t’i pranojnë pensionet në të cilat kanë të drejtë.

Letra e 12 shkurtit 2002 drejtuar Departamentit për Mirëqenie Sociale në të cilën nënvizoheshin shqetësimet rreth skemës së ndihmës sociale në Kosovë.

Letra kryesuesit të Departamentit të Shërbimeve Publike pranë UNMIK-ut (4 janar 2002) lidhur me mungesën e ujit të pijshëm për banorët e lagjes Hajredinaj në fshatin Koshutovë, komuna e Mitrovicës.

Letra drejtorit të Departamentit për Çështje Juridike pranë UNMIK-ut (8 mars 2002) në të cilën rekomandohej emërimi i një kolegji të gjykatësve ndërokmbëtar për ta dëgjuar një ankesë në një rast penal që kishte pasur mbulesë të gjërë nga mediat për shkak të implikimeve politike të tij.

Letra PSSP-së (12 mars 2002) në të cilën shprehej qëndrimi i Ombudspersonit që gjykatat që merren me procedurë penale në Kosovë nuk do të duhej të lejohen të përpiqen që, për një pjesë të asaj procedure, ta ushtrjnë juridikcionin e tyre jashtë Kosovës.

Letra zëvendësit të PSSP-së për Polici dhe Drejtësi (4 qershor 2002) në të cilën shprehej brenga që largimet apo largimet e planifikuara të shqiptarëve etnik që më parë kishin banuar në Mitrovicën veriore nga pronat në të cilat ata përkohësisht ishin duke qëndruar në Prishtinë do të bënte familjet e ndikuara të pashtëpi, për shkak të pamundësisë së kthimit të tyre në Mitrovicën veriore.

**21 tetor 2002:** Letra Administratorit komunal në Novobërdë lidhur me furnizimin joadekuat me ujë në zonën e Izvorit dhe Llabjanit..

**Më 30 tetor 2002, Administratori komunal e informoi Ombudspersonin që ishin ndërmarrë veprime për ta zgjidhur çështjen dhe nënvizoi vështirësitë në mirëmbajtjen e infrastrukturës për furnizimin me ujë të këtyre bashkësive, në atë që infrastruktura rregullisht ishte subjekt i dëmtimit dhe shkatërrimit nga ana e elementeve ekstreme.**

**22 nëntor 2002:** Letra PSSP-së në të cilën kërkohet ndihma e tij që përfaqësuesit e autorizuar (shqiptarë etnikë) të banorëve të dikurshëm (serbë etnik) të mund të marrin certifikatat e vdekjes nga autoritetet komunale në Gjakovë.

**Më 18 tetor 2002, PSSP-ja e lëshoi një Vendim Ekzekutiv (Nr. 2002/16) me të cilin udhëzoheshin autoritetet komunale që “me kohë të ndërmarrin veprimet e nevojshme për lëshimin e certifikatave të vdekjes”.**

**26 nëntor 2002:** Letra kryesueses së Zyrës së UNMIK-ut për Kthime dhe Komunitete në të cilën kërkohet nga ajo që të sigurojë që shkollave në Osojan (Komuna e Istogut) dhe Kolloni (komuna e Gjakovës) të u sigurohet ngrohje adekuate gjatë dimrit.

**Më 27 nëntor 2002, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e informoi Ombudspersonin lidhur me veprimet që i kishte ndërmarrë për ta zgjidhur problemin.**

**27 nëntor 2002:** Letra PSSP-së lidhur me kushtet që rregullonin faljen e borxheve të kaluara për energji elektrike të personave të varfër dhe të paaftë, ashtu si ishte e vendosur me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut Nr. 2002/19 mbi pagesën e borxheve për shërbimet e energjisë elektrike. Ombudspersoni vërejti që Udhëzimi e kushtëzonte të drejtën e faljes së borxheve të kaluara me atë që individit në fjalë të pranojë përgjegjësinë për pagesën e shpenzimit momental dhe të ardhshëm të energjisë elektrike, por kishte dështuar ta marrë parasysh faktin që njerëzit e varfër që në të kaluarën nuk kanë qenë në gjendje ta paguanë shpenzimin e energjisë elektrike, vështirë që do të mund ta bënin këtë edhe në të ardhmën. Ai gjithashtu ceku që lajmërimet zyrtare që një individ do t'i ndërprehet furnizimi me energji elektrike nuk përmbanin ndonjë informatë rreth mundësisë që mund të kërkohet falja e borxhit.

Në fund, ai theksoi që Ligji mbi Marëdhëniet Detyrimore, si ligj i aplikueshëm në Kosovë, i ndalon ofruesit e shërbimeve publike të kërkojnë pagesa për borxhe të grumbulluara nga ana e konsumatorëve më shumë se dymbëdhjetë muaj para kërkesës për pagesë. Në letërën vijuese **më 27 janar 2003**, Ombudspersoni përsëriti propozimin që e kishte bërë në tetor 2001 për të adoptuar qasjen e përgjithshme të praktikuar nga shumica e shteteve evropiane, që në përfundimet e ofruara individëve që pranojnë ndihmë sociale të përfshihet edhe një nivel minimal i shpenzimit të energjisë elektrike.

**Në një letër më 4 shkurt 2003, zëvendësi kryesor i PSSP-së theksoi që autoriteti drejtues i Shërbimeve Publike në Kosovë ishte duke përgatitur propozime për reduktimin e tarifave për nivelet minimale të shpenzimit të energjisë elektrike për konsumatorët e varfër dhe të paaftë. Megjithatë, në letër nuk u përmend zbatueshmëria e ligjit relevant vendor.**

**28 nëntor 2002:** Letra Agjencionit Evropian për Rindërtim (AER) lidhur me mungesën e sigurisë dhe kushtet e mjera në trenin që qarkullonte mes Lipjanit dhe kufirit të Kosovës me Serbinë.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**

**4 dhjetor 2002:** Letra PSSP-së për t'u informuar rreth politikës dhe planeve të UNMIK-ut lidhur me përkrahjen, kthimin dhe integrimin e kosovarëve të etnicitetit shqiptar në Mitrovicën veriore.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**

**9 dhjetor 2002:** Letra PSSP-së në të cilën shpreheshin shqetësimet rreth zgjatjes së afatit të fundit për të paraqitur kërkesat pronësore pranë Drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore (DÇPB) prej 1 dhjetorit 2002 më 1 qershor 2003, dhe duke kërkuar sqarimin e tij rreth implikimeve të kësaj zgjatjeje për individët, kërkesat pronësore të të cilëve ishin në pritje për t'u zgjidhur për periudha të gjata kohore. Shqetësimet e Ombudspersonit lidhur me këtë çështje lindën pas letrës së **3 tetorit 2002** nga ana e kryesuesit të Procesimit të rasteve pranë DÇPB-së me të cilën e informonte Ombudspersonin që DÇPB kishte vendosur ta zvarrisë punën me një numër të

madh të kërkesave pronësore deri në skadimin e afatit të fundit për të parashtruar kërkesa të tilla, si dhe nga ankesat nga individët e ndryshëm kundër këtyre zvarritjeve që ata i kishin paraqitur pranë Ombudspersonit.

**Më 20 dhjetor 2002, zëvendësi kryesor i PSSP-së i ofroi Ombudspersonit një kopje të Urdhërit ekzekutiv me të cilin zgjatej afati i fundit. Në shkresë nuk ishte përfshirë asgjë rreth implikimeve të kësaj zgjatjeje për individët që ishin në pritje të zgjidhjes së kërkesave të tyre pronësore.**

**17 dhjetor 2002:** Letra kryesuesit të Departamentit të UNMIK-ut për Çështje Juridike në të cilën kërkohej nga ai ta ushtrojë të drejtën e tij për të rekomanduar që PSSP-ja ta emërojë një prokuror ndërkombëtar dhe një kolegj të gjykatësve ndërkombëtar për ta shqyrtuar ankesën e Sami Moraliut dhe të tjerëve kundër vendimit të 21 tetorit 2002 të Gjykatës komunale në Prizren, duke marrë parasysh vrasjen e një dëshmitari në procedurën gjyqësorë në instancën e parë dhe kërcënimet ndaj individëve ose anëtarëve të familjes të individëve që kishin qenë të përfshirë në këtë rast.

**Më 17 shkurt 2002, drejtori i Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut e informoi Ombudspersonin që Departamenti ishte duke punuar me prokurorët vendorë për të zhvilluar çështjet që kishin lindur nga këto raste dhe që Departamenti do ta “vlerësonte shkallën e angazhimit të ndërkombëtarëve që është e mjaftueshme për të siguruar që rastet të përparojnë në kuptim të kërcënimeve potenciale ndaj shërbimeve vendore të judikaturës dhe prokurorisë”.**

**17 januar 2003:** Letra zëvendësit të PSSP-së në të cilën kërkohej sqarimi i procedurave të UNMIK-ut për lëshimin e certifikatave të lindjes në kuptim të vështirësive me të cilat ballafaqoheshin individët që paraqitnin certifikatat e tilla të lindjes pranë konzullateve të caktuara gjatë proceseve të aplikimit për vizë.

**Më 4 shkurt 2003, zëvendësi i PSSP-së i dërgoi një letër Ombudspersonit duke thekuar që nuk ekziston një problem i tillë.**

**27 januar 2003:** Letra Ministrit të Shëndetësisë në të cilën kërkohej nga ai të sigurojë që pajisjet dhe shërbimet e dializës së veshkës të ofrohen në spitalin në Llapje Sellë, duke pasur parasysh veshitësitë që pacientët serbë vazhdimisht duhet të udhëtojnë për në Mitrovicë ose Serbi në mënyrë të të ju ofrohen shërbimet themelore mjekësore.

**Më 10 shkurt 2003, sekretari i përhershëm i Ministrit të Shëndetësisë e informoi Ombudspersonin që Ministri nuk e kishte gjetur të nevojshme të ofrojë këto pajisje dhe shërbime për këtë bashkësi dhe sugjeroi që individët të cilëve u nevojitej dializa do të duhej të shfrytëzonin shërbimet e mundshme në Spitalin Univerzitar të Prishtinës.**

**30 januar 2003:** Letra administratorit komunal të UNMIK-ut në Obiliq në të cilën kërkohej intervenimi i tij për të përmirësuar kushtet e jetës në Janjina Vodë, rrethanat e të cilit ishin më të disfavorshme në krahasim me fshatrat tjera në këtë komunë.

**Më 3 shkurt 2003, administratori komunal e informoi Ombudspersonin rreth masave që ishin ndërmarrë për të përmirësuar kushtet e jetës në Janjina Vodë, në veçanti furnizimi me ujë, shërbimet mjekësore dhe çështje tjera të ngjajshme siç ishin ndriçimi dhe transporti.**

**25 shkurt 2003:** Letra kryetarit të Komisioni për Çështje Pronësore dhe Banesore lidhur me vonesat e gjata dhe parregullsitë tjera procedurale gjatë punës me një numër të kërkesave pronësore (të përfshira në një listë të bashkangjitur letrës) që ishin në pritje për t'u zgjidhur pranë Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore apo pranë vetë këtij Komisioni, dhe në të cilën theksohej që asnjëra nga këto organe administrative nuk ishte duke i përmbushur obligimet e tyre ligjore as sipas Rregulloreve relevante të UNMIK-ut, as sipas Ligjit mbi Procedurën Administrative.

**Në një letër më 14 prill 2003, ushtruesi i detyrës së referentit të Komisionit për Çështje Pronësore dhe Banesore i siguroi Ombudspersonit një kopje të Rezolutës Nr. 7 (11 prill 2003) të Komisionit. Në këtë Rezolutë, Komisioni e kishte përshkruar natyrën e procesit të kërkesave, duke theksuar që vëllimi i tyre i madh e arsyetonte vendosjen e ngadalshme mbi kërkesat pronësore. Rezoluta gjithashtu theksoi që Komisioni nuk e pranonte zbatueshmërinë e Ligjit mbi Procedurën Administrative në punën e Drejtorisë apo Komisionit. Rezoluta nuk përgjegjej në çështjet tjera të ngritura në letrën e Ombudspersonit, e në**

**veçanti në dështimin e këtyre organeve për të ju përmbajtur afateve të fundit dhe kërkesave procedurale të vendosura në Rregulloren e shpallur nga vetë ata.**

**5 mars 2003:** Letra zëvendësit të PSSP-së për Polici dhe Drejtësi duke e informuar rreth shqetësimeve të shprehura nga gjykatësit dhe prokurorët në Mitrovicë lidhur me parregullsitë e qarta në zhvillimin e hetimeve të policisë dhe çështjeve tjera lidhur me to. Ombudspersoni vërejti që ai kishte përmendur shumë nga këto çështje në raportin e tij mbi rastin A.P.L. (17 tetor 2001) dhe kërkoi nga zëvendësi i PSSP-së informata rreth përparimit në implementimin e rekomandimeve të bëra në atë raport.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër, dhe Ombudspersoni nuk është informuar përmes kurrfarë rrugëve tjera rreth implementimit të rekomandimeve të tij në rastin e lartpërmendur.**

**21 mars 2003:** Letra Minsitrit të Tregtisë dhe Industrisë në të cilën shpreheshin shqetësime rreth parregullsive në regjistrimin e bizneseve. Në veçanti, Ombudspersoni vërejti që individët, aktivitetet profesionale të të cilëve janë të rregulluara përmes shoqatave profesionale të cilat ushtrojnë funksione publike të ligjit (p.sh. Oda e Avokatëve) por të cilët në fakt nuk janë anëtarë të shoqatave të tilla, nuk do të duhej të kenë zotësinë juridike të regjistruhen si biznese që pohojnë të ofrojnë shërbime të tilla profesionale. Ai gjithashtu shtoi që individë të ndryshëm ishin regjistruar si notarë, edhe pse profesioni i tillë nuk ekziston sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë.

**Më 14 maj 2002, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë dërgoi një përgjegje në këtë letër në të cilët kishte theksuar që ai konsideronte që regjistrimi i avokatëve dhe notarëve si biznese nuk kishte lidhje me rregulloren, bazën ligjore apo funksionet publike ligjore të këtyre profesioneve.**

**25 mars 2003:** Letra PSSP-së në të cilën referoheshin një numër i letrave të mëhershme (në të cilat nuk kishte pasur përgjegje) drejtuar atij, duke kërkuar ndihmën e tij për të marrë informata mbi hetimet e policisë në zhvillim e sipër mbi rastet, lidhur me të cilat individët kishin paraqitur aplikacione pranë Ombudspersonit, dhe për të cilat autoritetet e Policisë së UNMIK-ut kishin dështuar të përgjegjen në kërkesa të drejtëpërdrejta dhe të përsëritura të Ombudspersonit.

**On 4 prill 2003, zëvendësi i Përfaqësuesit Special të PSSP-së e dërgoi një përgjegje të pjesshme në këtë letër (shih gjithashtu Përmbledhjen e rastit: Afrim Selaci kundër UNMIK-ut, faqe 21)**

**22 prill 2003:** Letra kryetarit të Bordit ekzekutiv të KEK-ut në të cilën kërkohet që Bordi të ndërmarrë veprime urgjente për ta vendosur një lokacion të ri në të cilin do të mund të zhvendoseshin banorët e Dardhishtës, komuna e Kastriotit, të cilët ishin të rrezikuar nga instalimet e KEK-ut.

**Më 9 maj 2003, kryetari i Bordit ekzekutiv të KEK-ut i dërgoi Ombudspersonit një letër në të cilën shprehte pikëpamjen që numri i familjeve që komuna i kishte përfshirë në listën e banorëve të rrezikuar ishte shumë më i madh se numri i përmendur në diskutimet mes palëve të përfshira. Ai gjithashtu shtoi që familjet të cilat ishin identifikuar më herët kishin ofruar prova adekuate të pronësisë mbi pronat e tyre, që është një parakusht për ndarjen e pronave tjera, kurse familjet tjera shtesë nuk e kishin bërë këtë.**

**5 qershor 2003:** Letra PSSP-së në të cilën kërkohet nga ai të intervenojë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për të parandaluar Njesitë për regjistrimin e biznesit në mbarë Kosovën të pranojnë aplikacione për Regjistrim të përkohshëm të biznesit nga individët të cilët ose nuk kanë qenë kurrë të pranuar në Odën e Avokatëve të Kosovës ose kanë qenë të larguar nga kjo Odë për shkak të shkeljeve të rënda të Kodit të etikës profesionale të avokatëve, apo nga individët të cilët dëshirojnë të regjistruhen si “notarë” edhe pse nuk ka baza në ligjin e aplikueshëm në Kosovë për licensimin apo praktikimin e këtij funksioni publik.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**

**24 June 2003:** Letra drejtorit të Departamentit të UNMIK-ut për Drejtësi lidhur me kushtet në burgun e Dubravës, duke përfshirë përmirësimet e lokaleve higjienike për të burgosurit dhe qasjen e tyre në përkujdesjen mjekësore dhe botën e jashtme, në pajtim me rregullat evropiane dhe ndërkombëtare mbi trajtimin e të burgosurve.

**Nuk ka pasur përgjegje në këtë letër.**